

SONILA BOÇI

PARTIA KOMUNISTE E SHQIPËRISË DHE BALLI KOMBËTAR GJATË MUAJVE GUSHT-SHTATOR 1943

Muajt gusht-shtator 1943 janë një moment shumë i rëndësishëm për historinë e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Ato ishin një moment kthese në raportet e grupeve ndërluftuese të kësaj lufte dhe patën ndikim të padiskutueshëm edhe në Shqipërinë e vogël. Ky artikull fokusohet kryesisht në marrëdhëniet midis dy grupeve politike në Shqipëri Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH) / Lufta Nacionalçlirimtare (LNÇ) dhe Ballit Kombëtar (BK). Ai ka synim të analizojë arsyet dhe faktorët që ndikuan në tensionimin e marrëdhënieve mes tyre që përfundoi në një luftë civile, e cila u bë një prej tiparevetë historisë së Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Marrëdhëniet midis PKSH/LNÇ-së dhe Ballit Kombëtar pas Marrëveshjes së Mukjes

Ndryshimet në frontet kryesore të luftimit e gjetën situatën politike në Shqipëri mjaft të paqartë. Rivaliteti, problemet dhe kontradiktat që kishin ekzistuar deri atëherë midis dy grupimeve më të mëdha jofashiste në vend: Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe Ballit Kombëtar, tanimë po shndërroheshin në një konfrontim të ashpër. Shumica e studiuesve pranojnë faktin se gushti i vitit 1943, solli një ndryshim drastik në marrëdhëniet mes Ballit Kombëtar dhe PKSH, por edhe në rezistencën e shqiptarëve kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë. Një pjesë e studiuesve përcaktojnë dështimin e marrëveshjes së arritur në mbledhjen e Mukjes si shkakun kryesor të acarimit të marrëdhënieve ndërmjet PKSH dhe Ballit Kombëtar¹. Të tjerë mendojnë se marrëveshja e arritur

¹ Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian (1939-1943)*, Tiranë: Eneas, 2015, f. 318-319; Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, Tiranë: Toena, 2014, f. 51; Uran Butka, *Lufta Civile në Shqipëri 1943-1945*, Tiranë: Drier, 2006, f. 84.

në Mukje ishte fabrikim i pushtuesve gjermanë, si e tillë ishte një marrëveshje “e lindur e vdekur”².

Në dilemën nëse ishte dështimi i Marrëveshjes së Mukjes shkaku që çoi në acarimin e këtyre marrëveshjeve, apo dështimi i saj ishte pasojë e zhvillimeve të brendshme, por edhe asaj që po ndodhte në arenën e madhe të Luftës së Dytë Botërore, unë mendoj se argumentet flasin më shumë për rastin e dytë. Lëvizja Nacionalçlirimtare drejtohej nga PKSH-ja e cila që në fillimet e saj kishte përcaktuar qartë objektivin afatgjatë për zhvillimin e revolucionit popullor, si parakusht për marrjen e pushtetit. Në gusht 1943, Lëvizja Nacionalçlirimtare kishte pasur rritje sasiore dhe cilësore. Ajo kishte qenë më e suksesshme në mobilizimin e një numri të konsiderueshëm të rinjsh midis moshave 16-24 vjeç, të cilët dolën vullnetarë në formacionet ushtarake të Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Falë centralizimit të skajshëm të vendimmarrjes politike dhe ushtarake, disiplinës së hekurt dhe entuziazmit të këtyre të rinjve, ajo kishte mundur të regjistronte në biografinë e saj ushtarake një sërë aksionesh të suksesshme kundër pushtuesve italianë. Nga pikëpamja e organizimit strukturor-ushtarak, duke filluar nga pranvera e vitit 1943, LNÇ kishte kaluar nga faza e organizimit të çetave territoriale në njësi më të mëdha luftarake (batalione). Më 10 korrik 1943, në Konferencën e Labinotit ishte formuar Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe ishte vendosur organizimi i strukturave ushtarake në nivel brigade³. Në kohën e krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, raportohej se forcat ushtarake të mobilizuara në batalione dhe çeta kapnin shifrën 4 290 vetë dhe, së bashku me çetat vullnetare të fshatrave, mund të mobilizonin rreth 10 000 të tjerë⁴.

Në krahun tjetër, Balli Kombëtar, një organizatë me prirje republikane, liberale dhe nacionaliste, me gjithë popullaritetin e spikatur që krerët e tij gëzonin, nuk arriti të unifikonte si qëndrimet politike, ashtu

² Marenglen Kasmi, “Marrëveshja që lindi e vdekur”, në: <https://dritare.net/marreveshja-ge-lindi-e-vdekur/> vizituar më 26 shkurt 2020.

³ Në kohën që zhvillohej takimi i dy grupimeve politike në Mukje, drejtuesit më të lartë të PKSH-së ishin zhvendosur në Kucakë të Korçës dhe po përgatiteshin për përrurimin e Brigadës I Sulmuese, e cila kishte marrë ndihma dhe pajisje ushtarake nga britanikët.

⁴ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi (më tej: F.) 41/Arkivi i Partisë për Luftën (më tej: APL), Viti (më tej: V.) 1943, Dosja (më tej: D.) 1, fl. 9-10. Statistika mbi numrin e forcave të armatosura të UNÇ.

dhe veprimet ushtarake. Nga pikëpamja e organizimit strukturor ushtarak kishte mbetur në nivelin e çetave territoriale, të cilat bazoheshin pothuajse tërësisht në autoritetin personal të krerëve lokalë. Statistika të vetë organizatës mbi numrin e forcave të armatosura të saj nuk kemi mundur të gjejmë. Një dokument i misionit britanik, i vendosur në Shqipëri në maj 1943, vlerëson se numri i forcave ushtarake të mobilizuara në çeta të rregullta me siglën e Ballit Kombëtar arrinte shifrën e 900 vetëve. Por, i njëjti dokument raportonte se, Balli Kombëtar, në rast luftimesh, mund të thërriste në armë 10 900 vetë⁵. Biografia ushtarake e organizatës shënonte një listë luftimesh, e cila më shumë se një angazhim politik i qartë i organizatës për rezistencë kundër pushtuesit, lidhej me vullnetin e disa emrave të përveçëm të komandantëve të Ballit, si: Hysni Lepenica, Isuf Luzaj, Skënder Muço, Ismail Petrela, Abaz Ermenji, Dhimitër Fallo, Abdulla Alarupi etj. Drejtuesit kryesorë të Ballit nuk ishin shprehur qartë mbi rezistencën e armatosur kundër pushtuesit fashist italian. Dokumentet italiane shpesh i konsiderojnë disa prej komandantëve të Ballit, si filoitalianë dhe mbështetje për autoritetet e pushtimit në luftën kundër komunistëve⁶. Vendimi politik i Ballit Kombëtar për t'u përfshirë aktivisht në këtë rezistencë i takonte korrikut të vitit 1943⁷.

⁵ M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian ...*, f. 271.

⁶ Si organizatë me një program në thelb antikomunist dhe nacionalist, Balli Kombëtar mund të mbështetej dhe në tolerancën e heshtur të autoriteteve italiane të pushtimit. Propaganda nacionaliste e Ballit nuk binte ndesh me qëllimet e politikës italiane për të nxitur irredentizmin e shqiptarëve, ndërsa antikomunizmi i tij u shërbente shumë mirë interesave të pushtuesit. Kështu autoritetet e pushtimit toleronin aktivitetin propagandues të Fazlli Frashërit, Ali Këlcyrës etj., për sa kohë që ai nuk shoqërohej me veprimtari kundër autoriteteve italiane. Kështu, p.sh. nga një dokument i datës 29 prill 1943 njoftoj se “Ali Këlcyra, person i njohur tashmë, dje më datë 27 të këtij muaji foli para popullit të Libohovës duke e ftuar që të bashkëpunojë me autoritetet dhe që t'i luftojë komunistët. Do të mbajë një fjalim me të njëjtin qëllim më datë 28 të këtij muaji në Picar dhe në 29 në Tepelenë”. Për më tepër shih: *Shënime për Shqipërinë, dokumente historike italiane nga Arkivi Shtetëror Italian, prill-korrik 1943*, përgatitur për botim nga Bejtullah Destani dhe Ethem Çeku, Londër: Qendra për Studime Shqiptare, 2015, f. 109. Në të njëjtin botim, autoritetet do të shprehen kështu edhe për komandantë të tjerë të Ballit Kombëtar si: Safet Butka, Abaz Ermenji etj.

⁷ *AQSH*, F. 270/APL, V. 1943, L. 1, D. 11, fl. 18. Trakt i Ballit Kombëtar, i cili njofton se Komiteti Qendror i Ballit Kombëtar ka dalë në mal për të drejtuar më mirë luftën kundër pushtuesve, korrik 1943.

Balli Kombëtar në Mukje arriti një fitore të spikatur politike, e cila nuk pasqyronte ekuilibrin e forcave dhe aktivitetin ushtarak. Ai arriti të marrë në tavolinë, atë çka nuk e kishte në terren⁸. Balli arriti të plotësonte nga marrëveshja e arritur në Mukje shumëçka prej pikave të programit të tij politik: një organizatë dualiste, në të cilën Balli Kombëtar dhe Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të kishin përfaqësim të barabartë⁹; premtimin për një sistem demokratik të qeverisjes e zgjedhje të lira dhe, mbi të gjitha, premtimin për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare, për të cilën komunistët, deri atëherë, nuk kishin formuluar asnjë qëndrim publik. E vetmja gjë që fitoi PKSH/LNÇ nga Marrëveshja e Mukjes ishte premtimi nga ana e Ballit Kombëtar për t'u përfshirë në rezistencën e armatosur kundër pushtuesit aktual, apo çdo pushtuesi tjetër¹⁰. Kjo fitore politike i jepte përparësi Ballit, veçanërisht në ndryshimet e situatës politike ndërkombëtare dhe raportit të forcave ndërluftuese të Luftës së Dytë Botërore. Ajo e shndërronte Ballin në faktor të rëndësishëm politik për të ardhmen e Shqipërisë, gjë që nuk mund të pranohej kurrsesi nga drejtuesit e PKSH-së, e cila nuk pranonte rivalë në pushtetin e saj. Në këtë logjikë, mendoj se ishte çështja e pushtetit, më shumë sesa përfshirja e kufijve etnikë, arsyeja që e “vrau” Mukjen.

Sakaq, Balli Kombëtar u tregua i gatshëm të jetësonte marrëveshjen e arritur në Mukje. Më 4-5 gusht 1943, çetat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe ato të Ballit Kombëtar të drejtuara nga Abaz Kupi, sulmuan së bashku forcat e pushtuesve italianë në Qafë Shtamë¹¹. Drejtuesit e lartë të Ballit Kombëtar nxituan ta publikonin marrëveshjen e arritur, gjë që shkaktoi reagim të ashpër të Enver Hoxhës. Ai në një letër që i dërgonte Ymer Dishnicës, më 9 gusht 1943, e fajësonte atë për mungesën e informacionit në lidhje me këtë trakt. Ai e akuzonte

⁸ A. Lalaj, *Dosjet e Luftës ...*, f. 59.

⁹ Në të vërtetë, Balli Kombëtar nga Marrëveshja e Mukjes kishte siguruar shumicën në Komitetin për Shpëtimin e Shqipërisë, pasi ajo gjithmonë shpresonte të kishte votën e anëtarëve jokomunistë të Frontit Nacionalçlirimtar, siç ishte, për shembull, Abaz Kupi.

¹⁰ *AQSH*, F. 14/APL, V. 1943, D. 21, fl. 9-10. Procesverbali i mbledhjes së Mukjes.

¹¹ *Po aty*, F. 270/1/APL, V. 1943, D. 9, fl. 3. Trakt i Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, pa datë; shih gjithashtu: M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian ...*, f. 311.

Dishnicën se e kishte vendosur Partinë Komunistë para *a fait accompli*¹² dhe se me marrëveshjen e arritur në Mukje kishin kapërcyer kompetencat që u kishte ngarkuar atyre Konferenca e Labinotit¹³. “Ti ke ra këmb e krye në pozitat e Ballit me këtë trakt, - i shkruante Hoxha, - ku flitet për Shqipni etnike dhe ku nuk flitet aspak për luftën kundra fashizmit dhe për luftën tonë. Asnjë fjalë nuk ka në trakt për Partinë Komuniste. Bashkimi e keni ba me kondita paritetike në mes të Ballit që është një organizatë dhe Këshillit Nacionalçlirimtar që është një front”¹⁴. Sipas Hoxhës, Balli ishte “vërsul me tërë forcat” për të marrë pushtetin “për të na larguar neve nga radha e parë ku jemi sot dhe për të na dhanë shqelmin nesër; veçanërisht kur konditat politike të jashtme po rukullisen juve nuk deklaroni luftën kundra fashizmit, por proklamoni independencën kur okupatori është edhe brenda, gjithashtu dhe Shqipnin Ethnike, thezë që mbron vetëm fashizmi dhe reaksioni”¹⁵. Ai i kërkon Dishnicës të mos shpërndahet në asnjë mënyrë trakti dhe të ndërpriten të gjitha bisedimet me Ballin.

Në të vërtetë, sukseset e “Ushtrisë së Kuqe” në frontin e Lindjes; rënia e qeverisë së Musolinit, pas grushtit të shtetit të Badoglios, dhe mbi të gjitha lajmi i rremë i përhapur nga Aleatët Perëndimorë për hapjen e frontit të dytë në Ballkan, ndryshoi qasjet e forcave politike në Shqipëri. Çështja e pushtetit për të dy krahët filloi të diskutohej jo më si një çështje që i përkiste të ardhmes, por si një realitet për të cilin duhej gjetur zgjidhje e menjëhershme, gjë që, në perceptimin e drejtuesve të lartë të PKSH-së, e bënte fitoren e Ballit në Mukje më të spikatur. Ishte kjo situatë politike një nga arsyet kryesore, që i vendosi këto grupime politike përballë njëra-tjetrës. Ndryshimi midis dy formacioneve politike qëndronte në modelin e sistemit politik në Shqipërinë e pasluftës. Ndërsa

¹² *AQSH*, F. 14/APL, V. 1943, D. 21, fl. 22. Letër e Enver Hoxhës për Ymer Dishnicën, 9 gusht 1943.

¹³ Në Konferencën e Këshillit Nacionalçlirimtar të mbajtur në Labinot, më 4-10 korrik 1943, nuk u diskutuan në detaje parimet mbi të cilat do të zhvilloheshin bisedimet me Ballin. E vetmja linjë bisedimi ishte ajo e “tërheqjes së Ballit në luftë”. *Po aty*, F. 40/APL, V. 1943, D. 3, fl. 20. Fjala e Ymer Dishnicës dhe Enver Hoxhës në Konferencën e KPNÇ, të mbajtur në Labinot, 9 korrik 1943.

¹⁴ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 21, fl. 22. Letër e Enver Hoxhës për Ymer Dishnicën, 9 gusht 1943.

¹⁵ *Po aty*.

PKSH-ja synonte një sistem politik monist, Balli Kombëtar mbronte idenë e një demokracie shumëpartiake.

Ende pa marrë informacion për rezultatin e mbledhjes së Mukjes, drejtuesit e PKSH-së filluan të radikalizonin qëndrimin ndaj Ballit Kombëtar. Që në fillim të gushtit, midis dy grupimeve politike, veçanërisht në zonën e Korçës ku ishin vendosur përkohësisht drejtuesit e lartë të PKSH-së dhe të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-ës, pati disa konflikte, të cilat mund të kishin degjeneruar në përplasje të armatosur. Rasti i parë ishte ai i fshatit Shipskë. Në jug të Shqipërisë, forcat ushtarake italiane kishin filluar një operacion kundër grupeve të rezistencës. Në shumë fshatra të jugut, ata kishin përdorur artilerinë, gjë që kishte detyruar banorët e këtyre zonave të braktisnin shtëpitë e tyre për të gjetur strehim në vende më të sigurta. Kjo kishte ndodhur edhe në fshatin Shipskë. Pas përfundimit të luftimeve, një çetë e Ballit Kombëtar kishte hyrë në fshat dhe kërkonte të përdorte shkollën e fshatit si vendstrehim të tyre. Komandanti partizan Nexhip Vinçani, duke zbatuar urdhrin e Enver Hoxhës, kishte dërguar një letër në formë ultimatumit në të cilën urdhëronte që çeta e Ballit të largohej menjëherë nga fshati, duke e konsideruar atë si bazë të formacioneve partizane. Komandanti ballist për të shmangur përshkallëzimin e situatës, ishte larguar nga ndërtesa e shkollës dhe ishte vendosur në një shtëpi, e cila u ishte vënë në dispozicion nga këshilli i fshatit, por edhe këtej ishin detyruar të largoheshin këtë radhë me urdhër të Sejfulla Malëshovës, një prej anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-ës¹⁶. Në letrën që Enver Hoxha i dërgon Ymer Dishnicës më 6 gusht 1943, jep këtë kronologji të ngjarjeve. Në një kohë kur ushtarët italianë ishin pozicionuar për të zhvilluar operacionin, njëri prej komandantëve të Ballit “Musa Moglica çon një letër (që ta vëmë brenda) [letrën, për fat të keq, nuk kemi mundur ta gjejmë - S.B.] ku na kërcënon që të ikim nga Kucaka”¹⁷. Pas një shkëmbimi letrash midis Nexhip Vinçanit dhe Musa Moglicës, forcat partizane kishin vendosur të viheshin në ndjekje të çetës balliste duke e

¹⁶ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 40, fl. 4. Ankesë e komitetit qarkor të Ballit Kombëtar në zonën e Korçës për qendrën e LNÇ në Vithkuq dhe, për dijeni, majorit britanik McLean, 23 gusht 1943.

¹⁷ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 21, fl. 18. Letër e Enver Hoxhës për Ymer Dishnicën, 6 gusht 1943.

lënë Voskopojën pa mbrojtje. Nga kjo situatë përfitoi ushtria italiane, e cila hyri në Voskopojë ku “forca [partizane] s’kish vetëm 20 vetë, të cilët tërhoqnë të sëmurët si nga Shën Prodhomi [manastiri] ashtu dhe nga Shipcka [Shipska], ku në shkollë kishim infermierinë. Voskopojën, ku s’kish asnjë fshatar pse kishin hikur në mal, e dogjën të tërë. Trupat tona u grumbulluan t’i goditnin por ata ikën, dhe tamam një ditë pasi ikën itatjanët Safet Butka, Fallua, Xhevdet Kapshtica e 50 veta të tjerë venë në Shpëskë, shqyejnë derën e shkollës dhe hynë brenda”¹⁸. Nga kjo letër e Enver Hoxhës dalin dy fakte të rëndësishme: *së pari*, prioritetet e drejtuesve komunistë kishin ndryshuar, pasi midis përballjes me pushtuesit italianë dhe forcave të Ballit Kombëtar, ata kishin zgjedhur të luftonin me këta të dytët; *së dyti*, pasojat e përplasjes midis grupimeve politike shqiptare i vuajti popullsia e pafajshme e Voskopojës.

Përplasje të tilla midis dy grupimeve politike nuk ishin të pazakonshme dhe kishin ndodhur edhe më herët. Por, ndërsa më herët, urdhrat e drejtuesve të lartë të PKSh-së ishin të shmangeshin konfliktet e armatosura dhe të rezervoheshin vetëm në “luftën” propagandistike, më 4 gusht 1943, ende para se Enver Hoxha të merrte letrën e Ymer Dishnicës të 3 gushtit, që e informonte mbi marrëveshjen e arritur në Mukje, ai në cilësinë e komisarit të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-ës, për herë të parë që nga krijimi i organizatës së Ballit Kombëtar, kishte firmosur urdhrin që formacionet partizane të sulmonin Ballin në Shpëskë dhe Voskopojë¹⁹.

Enver Hoxha në letrën e 6 gushtit drejtuar Ymer Dishnicës i kujton atij se situata ka ndryshuar dhe ata duhet të mos humbasin mprehtësinë e gjykimit “pse s’është ashtu (të paktën kështu mendojmë ne) si thotë Mustafa [Gjinishi] se fashizmi vdiq. Ay s’ka vdekur akoma dhe kemi për të bërë një copë herë luftë e bile të rreptë këtu në Shqipërinë tonë. Jo vetëm me fashizmin, por edhe me Ballin mundet pse kur ju po flitni atje për independencë e për proklamata këndeje haritëm deri sa për pak u qëlluar me horat e Ballit. Këtu poshtë po ju vemë një sërë dokumentash, të cilat t’ja u futni në syt delegatëve të Ballit, dhe në vënd që të na çjerrin veshët për independencën, të kontrollojnë punën dhe njerzit, pse puna mund të ashpësohet. ... të tëra ja u tregoni, dhe u thoni se këto gjëra nuk

¹⁸ *Po aty*.

¹⁹ *Po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 3, fl. 1. Letër e Enver Hoxhës për batalionin “Hakmarrja”, 4 gusht 1943.

na çojnë drejt Bashkimit por drejt luftës vëllavrasëse për të cilën jeni shkaktarë juve”²⁰. Siç kuptohet qartazi nga toni i kësaj letre, tanimë për drejtuesit më të lartë komunistë, Balli Kombëtar do të trajtohej si armik, njësoj si pushtuesi, por propaganda duhet të bënte të mundur që fajësia për konfliktin e ardhshëm civil, t’i binte Ballit.

Gjatë gjysmës së dytë të gushtit 1943, situata në marrëdhëniet mes dy grupeve politike ishte mjaft e paqartë. Në zonën e Korçës, ku për shkak të vendosjes aty të drejtuesve më të lartë të PKSh-së dhe Shtabit, në pritje të inaugurimit të Brigadës I, ndryshimi në vijën politike u përcoll më herët, incidentet mes dy grupimeve politike në Devoll, Kolonjë, në zonën e Voskopojës dhe Vithkuqit bëheshin gjithnjë e më të shpeshta. Në Gjirokastrë, Berat, Elbasan e gjetkë situata paraqitej disi më e qetë, por jo pa incidente. Kështu, në Gjirokastrë, disa prej komandantëve të Ballit, një prej të cilëve ishte Nexho Bejleri, kishin ndihmuar me informata, por edhe në veprime luftarake ushtrinë italiane²¹. Ata shpresonin të përfitonin nga situata e krijuar për të eliminuar forcat komuniste të krahinës, por kjo kishte rezultuar në një ngjarje tragjike për zonën e Libohovës, ku ishin vrarë shumë banorë civilë të fshatit²².

Ndërkohë strukturat lokale të PKSh-së dhe formacionet partizane morën urdhra dhe udhëzime për ndryshimin në qëndrimin ndaj Ballit Kombëtar. Kështu, në një letër që Sul Spahiu, një prej drejtuesve të PKSh-së në Kurvelesh u dërgonte drejtuesve të celulave të krahinës i porosiste ata të mos e shpërndanin madje, ta grisnin traktin që njoftonte mbi krijimin e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë. Sipas udhëzimeve që kishte marrë nga qendra, ai porosiste “Duhet shokë të kuptoni se Balli po mobilizohet për kolltuk për të na luftuar neve, duhet prandaj të kemi kujdes të forcojmë radhët tona, të mobilizojmë popullin rreth nesh që të mos lemë që reaksioni të na godasë dhe të na marrë frenat nga duart ... Për këtë gja, shokë, duhet të mobilizoni organizatën të tanë e të skjaroni shokët politikisht si duhet, të mobilizoni këshillat dhe miqtë. Agjitacioni ynë duhet ta mbulojë dhjetra herë atë të Ballit. Të shpjegohet me shokët

²⁰ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 21, fl. 18. Letër e Enver Hoxhës për Ymer Dishnicën, 6 gusht 1943.

²¹ *Po aty*, F. 17/APL, V. 1943, D. 9, fl. 39. Letër e Fushës (Teme Sejkos) për komitetin qarkor të PKSh për Gjirokastrën, 4 gusht 1943.

²² *Po aty*, F. 270/1, V. 1943, D. 4, fl. 1. Raport nr. 3 i Ali Këlcyrës për Komitetin Qendror të Ballit Kombëtar, 25 shtator 1943.

mirë e bukur vija e re me Ballin. Demaskim e jo luftë Ballit Kombëtar”²³. Letra përsëriste pothuajse *alla lettera* udhëzimet që Hoxha i kishte dhënë Ymer Dishnicës në atë të 6 gushtit. Letra me përmbajtje të njëjtë dërgoi dhe Haki Toska për komitetet qarkore në qarkun e Gjirokastrës, Pëllumb Dishnica për Korçën, Gogo Nushi për Tiranën etj. Deri në fund të gushtit të gjitha strukturat politike dhe ushtarake të PKSH-së ishin njoftuar për qëndrimin që duhet të mbanin ndaj Ballit.

Ndërsa PKSH/LNÇ po përgatitej për t’u përballur me Ballin, pjesa më e madhe e drejtuesve qendrorë dhe lokalë të tij ishin ende me shpresën e zbatimit të vendimeve të marra në Mukje. Më 11 gusht 1943, Fazli Frashëri dhe Jani Dilo dy drejtuesit e komitetit qarkor të Ballit Kombëtar për Korçën i dërguan një letër krerëve ushtarakë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare që gjendeshin në zonën e Vithkuqit, në të cilën i kërkojnë takim “për të zgjidhur çështjet e varura midis të dy organizatave t’ona dhe mundësisht për të arritur në një koordinim të përpjekjeve t’ona, me kusht që marrëveshja eventuale të aprovohet prej këshillave respektive”²⁴. Më 15 gusht 1943, përfaqësuesit e Ballit Kombëtar në Komitetin për Shpëtimin e Shqipërisë: Ethem Haxhiademi, Vasil Andoni, Isuf Luzaj, Abaz Omari dhe Halil Mëniku shkuan në Orenjë të Çermenikës, vendtakimi i paracaktuar me përfaqësuesit e LNÇ-së, por mbledhja nuk u zhvillua asnjëherë²⁵.

Si për t’i treguar vullnetin e tyre për të luftuar pushtuesit, strukturat ushtarake të Ballit filluan një proces riorganizimi, madje disa çeta të tij ndërmoren veprime të suksesshme luftarake kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë. Më 8 gusht 1943, Safet Butka, kreu i Ballit Kombëtar në zonën e Kolonjës nënshkroi një marrëveshje me majorin britanik, Bill McLean sipas të cilës Balli Kombëtar në Korçë do të angazhohej menjëherë në veprime luftarake kundër ushtrive të Boshtit në segmentin rrugor Korçë-Barmash, Korçë-Pogradec dhe, në shkëmbim, do të siguronte mbështetje ushtarake nga britanikët, si dhe prezencën e një

²³ *Po aty*, F. 17/APL, V. 1943, D. 2, fl. 12. Letër e Shkëmbit drejtuar komitetit qarkor të PKSh për rajonin e Kurveleshit, 1943. Shumë konspirative.

²⁴ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 40, fl. 1. Letër nr. 6 e Komandës Ushtarake të Ballit Kombëtar për Komandën e Përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, 11 gusht 1943.

²⁵ U. Butka, *Lufta civile ...*, f. 66.

oficeri të tyre pranë shtabit të Ballit Kombëtar për Korçën²⁶. Pesë ditë më pas, forcat e komanduara nga Safet Butka, me ndihmën e oficerit britanik David Smile, organizuan një pritë ndaj një kolone gjermane që vinte nga Follorina. Sipas kujtimeve të D. Smile, sulmi kishte rezultuar i suksesshëm, pavarësisht mungesës së përvojës së luftëtarëve shqiptarë. Ata kishin arritur të dëmtonin shumë makina dhe të vrisnin 23 ushtarë gjermanë, pa asnjë humbje nga pala shqiptare²⁷. Ky sukses vinte pas dështimit të operacionit të Brigadës I të drejtuar nga Mehmet Shehu për të sulmuar forcat gjermane, gjë që shkaktoi pakënaqësi të misionit britanik ndaj komandantit partizan, formacionin e të cilit e kishin furnizuar me armatime dhe veshje, madje kishin ndihmuar edhe në stërvitjen e luftëtarëve.

Balli bëri përpjekje edhe për riorganizimin e strukturave ushtarake. Në një letër që Abaz Ermenji, komandant i forcave të Ballit Kombëtar për Beratin, i dërgon më 16 gusht 1943, Safet Butkës e njofton se një javë më parë kishte sulmuar qytetin, por “me gjith përpjekjet e jashtëzakonëshme, nuk munda t’a mar dot për shumë arsye”. Më tej, ai njofton vendimin e disa prej drejtuesve politikë dhe ushtarakë të Ballit Kombëtar të jugut të Shqipërisë për të bërë një mbledhje në Skrapar “për të caktuar një komandë të përbashkët, një Shtab dhe një Komitet politik të përbashkët për tërë Shqipërinë e jugës, në mënyrë që të koordinohen dhe t’unifikohen të gjitha veprimet t’ona politike-ushtarake”²⁸.

Krahas linjave themelore politike që adaptuan të dy grupimet, për shkak të mungesës së komunikimit (në rastin e formacioneve të UNÇ), ose politikave personale (në rastin e krerëve të Ballit Kombëtar), gjatë kësaj periudhe pati edhe devijime nga këto linja. Në Nivicë të Kurveleshit më 16 gusht 1943, çeta e Ballit Kombëtar e komanduar nga Sehit Shehu dhe Limoz Rushiti zuri pozicion prapa qafës së Kreshtënit ku ishte pozicionuar çeta partizane e Bregut të Detit prej 60-70 vetash në pritje të sulmonte një kolonë të ushtarëve italianë. Çeta e Ballit i kishte kërkuar asaj partizane të largohej përndryshe do ta qëllonin. Incidenti

²⁶ *Po aty*, f. 65

²⁷ David Smajli, *Vitet e mia shqiptare '43-'45, kujtimet dhe fotot e kolonelit anglez gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Tiranë: UET/Press, 2012, f. 61-62.

²⁸ *AQSH*, F. 270/APL, V. 1943, D. 41, fl. 3. Letër e Abaz Ermenjit për Safet Butkën, Ermenj, 16 gusht 1943.

përfundoi pa përplasje, pasi në ndihmë të çetës së Bregut të Detit kishte shkuar ajo e Kurveleshit të Poshtëm, si dhe çeta e terrenit²⁹. Edhe në Korçë, disa prej komandantëve të Ballit po tregoheshin shumë të ashpër kundër përfaqësuesve të PKSH/LNÇ. Në një letër që Nuri Hudënishti, komandant i Ballit Kombëtar që vepronte në zonën e Mokrës, i dërgonte Jani Dilos, njoftonte se Abdulla Alarupi, një tjetër komandant i Ballit, kishte “dhënë një urdhër në pjesëtarët e Ballit, se çdo komunist që të shifet të pushkatohet”. Nuriu ishte shqetësuar për një urdhër të tillë pasi ai kishte arritur një marrëveshje me nënkomandantin e batalionit partizan “Reshit Çollaku” për të bashkëvepruar për sa i takon veprimeve luftarake. Prandaj, ai kërkonte që “të ndalohej vepërimi për çka i përket zonës të Mokrës dhe të Gorës që simbas urdhënit të Z.uaj [Zotërisë suaj] është zona që më përket mua ... dhe qëllimi i jem sikurse e dini është bashkimi ushtarak në këtë zonë”³⁰. Përgjigjja e Jani Dilos, një prej drejtuesve të Ballit Kombëtar për qarkun e Korçës, ishte e menjëhershme. Ai nuk mohon dhënien e një urdhri të tillë nga A. Alarupi, por shprehet se “nxitohem t’u lajmëroj se as është dhënë dhe as do të hepet një urdhër që të pushkatohet ndonjë komunist. Abdullaj nuk është kompetent të japi një urdhër të tillë dhe as ndonji tjetër i Ballit Kombëtar. Përgënjeshtroi këto lajme. [Ato] janë të përhapura me qëllim që të futin ndër ne vëlla-vrasjen, dije se jemi një organizatë që në të, jo vetëm veprohet simbas urdhërave të qendrës, por edhe respektohet jerrarkija dhe njifen eprorët me kompetencat përkatse”³¹.

Ndërkohë që Balli Kombëtar ishte i ndarë ndërmjet përpjekjeve të drejtuesve të tij për të jetësuar marrëveshjen e arritur në Mukje dhe politikave personale të disa prej krerëve lokalë, njësitë e UNÇ-ës kaluan nga incidentet në provokime të sulmeve të armatosura kundër Ballit Kombëtar. Më 20 gusht 1943, ndërsa kalonin në zonën e Shërmërtirit një çetë e Ballit ishte sulmuar nga batalioni partizan “Hakmarrja” i komanduar prej Petrit Dumes e Josif Pashkos. Luftimet kishin përfunduar

²⁹ *Po aty*, F. 17/APL, V. 1943, D. 3, fl. 4. Letër e paplotë [pa emër] për KQ të PKSH, 27 gusht 1943.

³⁰ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 41, fl. 4. Letër e Nuri Hudënishtit për Jani Dilos, 27 gusht 1943.

³¹ *Po aty*, fl. 5. Letër e Jani Dilos për Nuri Hudënishtin, 28 gusht 1943.

me dy të plagosur dhe një të zhdukur nga ana e Ballit³². Në një letër të komitetit qarkor të Ballit, të cilën ai ia kishte dërguar për dijeni edhe misionit britanik, tërhiqej vëmendja se “ngjarja e hidhur, e vërtetuarë në Kolonjë, për veç humbjeve në njerës krijon rrezikun e luftës civile dhe na ul poshtë jo vetëm përpara aleatve po dhe na paraqet me të drejtë qytetas pa ndjenja atdhetarije, si qytetas që në kohën kur rreziku i atdheut duhet të i bashkojë e t’i lidhë me luftën e tyre shpëtimtare, ata i përdorin forcat e ngjallura me aqë ndihma nga populli Shqiptar për kapriço të tyre personale, për hak marrje ose për interesa partirash”³³. Në tonin e kësaj letre ishte e qartë se shpresat për bashkëpunim me forcat e UNÇ-ës ishin shuar dhe Balli ishte i gatshëm t’u përgjigjej me të njëjtën monedhë provokimeve të komunistëve. “Ne ju njoftojmë të mendoni shqiptarisht, - përmbillet letra, - dhe të mos na bini më qafët, se më në fund do të na shtërngoni jashtë dëshirës s’onë të kundër-veprojmë nuk ju kërkojmë ndihmë, pse e dimë se nuk do të dëshironit, por të paktën të na lini të qetë në punën t’onë, këtë kemi të drejtë t’ja u kërkojmë me të mirë si vëllazër e si Shqiptarë që jemi, dhe në raste të kundërtë e quajmë si detyrë të ju paralajmërojmë se tani e tutje ç’do pengim, sabotim, ose akti force do t’i përgjegjemi me të njëjtën mënyrë.”³⁴

Fillimi i armiqësive: marrëdhëniet mes PKSH/LNÇ dhe Ballit Kombëtar në shtator 1943

Incidentet midis dy grupimeve politike që kishin qenë sporadike gjatë gushtit filluan të intensifikohen gjatë muajit shtator. Kapitullimi i pritshëm i Italisë shtroi çështjen e zotërimit të materialit ushtarak të ushtrisë italiane. Kjo ishte arsyeja e dytë e rëndësishme, që i vendosi palët përballë njëra-tjetrës. Posedimi i armatimit të ushtrisë italiane do t’u krijonte një avantazh të dukshëm ushtarak çdonjërit grup që do të arrinte t’i siguronte ato. Për këtë arsye, porosia që drejtuesit lokalë të PKSH-së

³² *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 40, fl. 8. Letër e komitetit qarkor të Ballit Kombëtar për qendrën e LNÇ-së, Vithkuq, për dijeni majorit anglez McLean, 23 gusht 1943.

³³ *AQSH*, F. 270/APL, V. 1943, D. 40, fl. 8. Letër e komitetit qarkor të Ballit Kombëtar për qendrën e LNÇ-së, Vithkuq, për dijeni majorit anglez McLean, 23 gusht 1943; shih gjithashtu S. Butka, *Lufta civile ...*, f. 72.

³⁴ *AQSH*, F. 270/APL, V. 1943, D. 40, fl. 8. Letër e komitetit qarkor të Ballit Kombëtar për qendrën e LNÇ-së, Vithkuq, për dijeni majorit anglez McLean, 23 gusht 1943.

marrin nga qendra e tyre ishte që të kontrolloheshin me kujdes lëvizjet e Ballit, në mënyrë që ai të “mos bëjë ndonjë kompromis me ushtrinë italiane”³⁵. Urdhri i Enver Hoxhës ishte i qartë: Balli nuk duhej lejuar të armatosej.

Fushata për çarmatimin e ushtrisë italiane nuk shkoi sipas parashikimeve për të dyja palët. Një faktor i rëndësishëm ishte fakti se, në momentin e kapitullimit, ushtria italiane nuk kishte direktiva nga qendra se si duhej të sillej dhe kujt duhej t’i dorëzohej. I gjithë procesi i dorëzimit u la në vullnetin e drejtuesve ushtarakë italianë, të cilët bënë marrëveshje herë me UNÇ-ën, herë me Ballin dhe në raste të tjera vendosën t’i dorëzoheshin ushtrisë gjermane. Madje, në disa raste, komandantët italianë preferuan ta shkatërronin materialin luftarak që ky të mos binte në duar të UNÇ-ës. “Ushtria italiane në tërheqje, shkruante në një letër Haki Toska, - ka djegur shumë material e kjo i dedikohet oficerëve madhorë, të cilëve nuk u pëlqen ta dorëzojnë këtë material tek ne”³⁶.

Faktor tjetër ishte mungesa e organizimit të formacioneve politike dhe ushtarake, e cila në thelb shprehte nivelin ende të dobët të rezistencës shqiptare kundër pushtuesit italian. Në një relacion që Nako Spiru dhe Ymer Dishnica, i dërgojnë Enver Hoxhës më 15 shtator 1943, pohojnë se çështja e çarmatimit të ushtrisë italiane nuk kishte shkuar sipas parashikimeve, pasi “qarkori i Tiranës u kap i papregatitur si duhet prej situatës; organizimi dhe lidhjet nuk qenë aqë të shëndosha edhe të tilla që të munt t’i bënim ballë një situatë të tillë. Çetat u ndodhë larg dhe s’muntnë të përfitonin flakë më flakë ashtu si e donte situata e krijuar. Njësitë guerile ishin ... jo në gjendje sa të venë e të çarmatosin kazerma e depo”³⁷. I gjithë procesi nuk kishte pasur një plan të koordinuar, kështu që edhe ato armë që ishin marrë ishin përdorur “ku me kërcënime, ku me pare, ku me fjalë, por nonjë njësit nuk bëri nonjë aksion që të marë armë me forcë, dyke çarmatosur ushtarë italianë ose dyke sulmuar nonjë

³⁵ *Po aty*, F. 20/APL, V. 1943, D. 4, fl. 50. Letër e Dunavecit (Pandi Kristos) për komitetin qarkor të Korçës, 9 shtator 1943.

³⁶ *Po aty*, F. 17/APL, V. 1943, D. 3, fl. 8. Raport i komitetit qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSH, pa datë.

³⁷ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 21, fl. 28-30. Letër e Ymer Dishnicës dhe Nako Spirit për Enver Hoxhën, 15 shtator 1943.

depo”³⁸. Nako Spiru ankohet se “si shokët e organizatës ashtu edhe të çetave u suall si tepër bujarë me italianët ose agjentët e tyre të xhandarmërisë e të policisë, kishin tendencë të prisnin dorëzimin e jo ta provokonin ose t’i shtërngonin me armë në dorë e nga ana tjetër t’i sqaronin”³⁹.

Faktor tjetër i rëndësishëm, që ndikoi në mossuksesin e fushatës së çarmatimit të ushtarëve italianë, ishin edhe armiqësitë që kishin filluar me Ballin Kombëtar, të cilat kjo fushatë i bëri edhe më të dukshme. Në Gjirokastrë, Vlorë, Elbasan, Korçë, Berat pati një “garë” të ashpër midis Ballit Kombëtar dhe forcave të UNÇ-ës. Rasti më i spikatur ishte ai i marrëveshjes për të çarmatosur divizionin italian “Perugia” të vendosur në Grehot të Gjirokastrës. Më 12-13 shtator, përfaqësues të UNÇ kishin arritur një marrëveshje me komandantin e divizionit, gjeneral Chiminelo, sipas të cilës ai do t’ia dorëzonte armatimet e divizionit, por pasi ata të arrinin në Sarandë. Për të shpëtuar fytyrën e ushtrisë së mundur italiane, do të bëhej kinse një luftim⁴⁰. Çeta e Ballit Kombëtar e komanduar nga Hysni Lepenica, duke parë demarshet midis ushtarakëve italianë dhe forcave partizane, vendosën më 14 shtator 1943 të sulmonin forcat italiane në Grehot. Sipas relacionit që Haki Toska i dërgonte KQ të PKSH-së “italianët, kur panë se forcat e Ballit futeshin në kazerma, lajmëruan forcat tona të vendoseshin në një vend të caktuar e të rrinin në qetësi dhe njëkohësisht i hapën zjarr ballistëve”⁴¹. Pas një luftimi të shkurtër, çeta e Ballit u shkatërrua plotësisht. Në luftime humbën jetën 117 luftëtarë të Ballit, midis të cilëve edhe komandant Hysni Lepenica⁴². Më pas, komandanti italian nuk pranoi t’i dorëzonte materialin edhe forcave partizane dhe u nis drejt Sarandës, ku u shkatërrua plotësisht nga ushtria gjermane.

³⁸ *Po aty.*

³⁹ *Po aty.*

⁴⁰ *Po aty*, F. 17/APL, V. 1943, D. 3, fl. 6. Raport i komitetit qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSH, pa datë.

⁴¹ *Po aty.*

⁴² Për numrin e luftëtarëve të vrarë në Grehot, shifrat e dhëna nga dokumentet nuk konvergojnë. Sipas traktit të shpërndarë nga Balli Kombëtar në Grehot u vrarë 33 luftëtarë të tij, ndërsa relacioni i Haki Toskës pohon se ishin 117 ballistë të vrarë gjatë sulmit të Grehotit. Uran Butka në librin e tij *Lufta civile në Shqipëri (1943-1945)*, flet për 36 të vrarë.

Jo rrallë në “garën” midis forcave partizane dhe të Ballit Kombëtar për armatimet e italianëve ndërhyenin edhe oficerët e misioneve britanike. Enver Hoxha i shkruan me ironi Ymer Dishnicës mbi rastin e çarmatimit të garnizonit italian të Këlcyrës. Sipas Hoxhës, “Ushtarët trima të Korçës zunë nja 4000 italianë nga ana e Këlcyrës a e Përmetit dhe nuk i çarmatosnë se i ndaloi një oficer inglez; dhe këta, zotit agjentit të Inteligent Servisit ju binden më mirë se urdhrave të Shtabit Shqiptar dhe i lanë ushtarët e u futnë në Shtrungën e Ali Be Këlcyrës i cili i zhveshi nga të gjitha edhe topa edhe brekët, bile dhe oficerit inglez i tha si burrë, mos më çaj kokën”⁴³. Po kështu edhe në Vlorë, majori britanik nuk kishte lejuar që armatimi të zotërohej vetëm nga UNÇ-ja. “Me dorëzimin e Italisë, shkruhet në një letër që komiteti qarkor i Vlorës i dërgon KQ të PKSH-së, aliatët që kemi këtu kanë dashur që të përdorin një politikë të kundërt me atë të armëpushimit. Majori Ingles s’donte të armatoseshim duke çarmatosur ushtrinë Italiane. Për këtë punë ai na drejtonte letra me kërcënime, mirëpo kjo politikë nuk i shkoi mbasi i dham përgjigjen e duhur. Nga kjo politikë e gabuar e tij disa shokë të një krahinës sonë janë tërhequr duke lënë pa marrë disa pushkë që ndodheshin në një kullë. Këto armë me von u muarnë prej Ballit dhe shokët tanë mbetnë me gjishtë në gojë”⁴⁴. Në Dibër ndodhi e kundërta. Me ndërmjetësinë e kapitenit britanik, Hens të gjitha armatimet e divizionit “Firenze” të gjeneral Azzit⁴⁵ iu dorëzuan forcave të UNÇ-ës të komanduara nga Haxhi Lleshi⁴⁶.

Si pasojë e rivalitetit midis tyre, si UNÇ-ja, ashtu dhe forcat e Ballit Kombëtar nuk arritën të kishin suksesin e dëshiruar në posedimin e armatimeve të ushtrisë italiane. Ndonëse UNÇ-ja siguroi më shumë nga

⁴³ AQSH, F. 14/APL, V. 1943, D. 20, fl. 8-10. Letër e Enver Hoxhës për Nako Spirun dhe Dishnicën, 4 tetor 1943.

⁴⁴ Po aty, F. 18/APL, V. 1943, D. 4, fl. 3. Raport i komitetit qarkor të PKSH-ës për Vlorën drejtuar KQ të PKSH-ës.

⁴⁵ Gjeneral Azzi me pjesën më të madhe të divizionit “Firenze” do t’i bashkohet më vonë formacioneve të UNÇ.

⁴⁶ Faik Quku, *Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1944)*, vëll. II, Tiranë: ILAR, 2006, f. 280.

ky armatim se sa Balli Kombëtar, sërish pjesa më e madhe e arsenalit luftarak italian i ra në dorë ushtrisë gjermane⁴⁷.

Kur forcat ushtarake gjermane ngritën administratën e tyre në Shqipëri, marrëdhëniet mes dy grupimeve politike ishin armiqësore. Sa i takon pushtuesve të rinj gjermanë, drejtuesit e UNÇ u treguan që në fillim të prerë në qëndrimin ndaj tyre. Më 8 shtator 1943, Spiro Moisiu, komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-ës dhe Enver Hoxha me cilësinë e komisarit të tij, dërgoi një urdhër për Shtabin e sapoformuar të Zonës I Operative (në ditët në vijim iu dërgua të gjitha shtabeve të zonave). Drejtuesit e UNÇ-ës urdhëronin strukturat e tyre ushtarake “të godasin pa mëshirë armikun dhe tradhëtarët. Lufta që duhet t’i zhvilloni armikut duhet të mbajë karakterin e vërtetë të një ofensive të paprerë, me goditje të forta dhe në vende ku armiku nuk e pret, duke shkaktuar kësisoj humbje të mëdha dhe duke ruajtur efektivet t’ona”⁴⁸. Formacionet partizane urdhëroheshin të mbronin popullsinë civile nga raprezaljet e pushtuesit, por mbrojtja nuk duhet të bëhej rrezik për shpartallimin e formacioneve të UNÇ-ës. Pjesë e urdhrit ishte edhe “shpartallimi i tradhëtarëve dhe kolonës së pestë”. Në Korçë, Gjirokastrë, Tepelenë, Vlorë, Elbasan, Tiranë, Sarandë forcat e UNÇ-ës u angazhuan në luftime me ushtrinë gjermane gjatë gjithë muajit shtator⁴⁹. Disa prej tyre

⁴⁷ Ali Këlcyra, *Shënime për historinë e Shqipërisë*, përgatitur për botim nga Tanush Frashëri, Tiranë: Onufri, 2012, f. 188.

⁴⁸ *AQSH*, F. 41/APL, V. 1943, D. 3, fl. 40. Urdhër i Komandës së Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-ës për Komandën e Shtabit të Zonës I Operative, Vlorë-Gjirokastrë, 8 shtator 1943.

⁴⁹ Më 8 shtator 1943, forcat e UNÇ-ës të komanduara nga Haki Rushiti zhvilluan betejën e Konispolit ku mbetën të vrarë 27 partizanë shqiptarë dhe u plagosën 11 të tjerë. *Po aty*, F. 17/APL, V. 1943, D. 7, fl. 5. Raport i komitetit qarkor të PKSH-së për Konispolin drejtuar komitetit qarkor të PKSH-së për Gjirokastrën, pa datë. Po kështu në Drashovisë të Vlorës forcat e UNÇ arritën të mbanin për 24 ditë ushtrinë gjermane që vinte nga Greqia. Më herët ishte luftuar edhe në zonën e Kardhiqit. Në luftimet e Drashovicës kishte dashur të përfshihej edhe çeta e Ballit Kombëtar e drejtuar nga Azis Çami. “Nga ana tjetër Ballistat duke parë këtë gjendje deshën të paraqiteshin popullit si luftëtarë dhe dërguan atje ku ishim nevet një çetë prej 70 vetash. Ne duke kuptuar këtë gjë nuk i pranuan në luftë”. *Po aty*, F. 18/APL, V. 1943, D. 4, fl. 3. Raport i komitetit qarkor të PKSH-së për Vlorën drejtuar KQ të PKSH-së, pa datë. Enver Hoxha në një letër për Nako Spirun dhe Ymer Dishnicën i informon për një betejë me forcat gjermane në zonën e Petrelës në Tiranë. “Petrela u bë Verdun: - shkruan ai, - herë meret prej Gjermanëve herë prej nesh, tash që shkruaj letrën është në

përfunduan me sukses për forcat shqiptare, por në shumë prej tyre partizanët nuk e përballuan dot forcën ushtarake të ushtrisë së organizuar gjermane. Në shenjë hakmarrjeje, trupat gjermane kryenin raprezalje ndër popullsinë civile, duke sjellë shumë fatkeqësi për krahinat si Korçë, Tepelenë, Vlorë etj.

Në marrëdhëniet me Ballin Kombëtar dhe grupimet e tjera politike jokomuniste, linja politike e PKSH/LNÇ u ravigjzua qartë në Konferencën e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar në Labinot (4-8 shtator 1943): luftë kundër pushtuesit, si rruga e vetme për të fituar mbështetës dhe siguruar të qenit të vetmit mbartës së pushtetit të së nesërme. Për t'ia arritur kësaj duheshin defaktorizuar kundërshtarët politikë. Në këtë proces, komunistët shqiptarë u ndihmuan edhe nga politika e pushtuesve gjermanë, të cilët arritën ta zhvendosnin “peshën kryesore të luftës guerrile dhe urrejtjes në luftë nga pushtuesit te shqiptarët”⁵⁰.

Në procesin e defaktorizimit të kundërshtarëve politikë tanimë asnjë mjet nuk ishte i përjashtuar, as propaganda e lufta politike, madje, as përdorimi i armëve në ato zona ku forcat e UNÇ-ës e ndjenin veten të fuqishme. Synimi i vetëm ishte që, në rast të zbarkimit të Aleatëve të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, secili nga grupimet politike të mund të tregonte epërsinë e tij politike. Drejtuesit e PKSH-së u treguan më të qartë në synimet dhe mjetet për t'i realizuar ato. Më 9 shtator 1943 në mbrëmje, pra një ditë pas mbarimit të Konferencës së Labinotit, Enver Hoxha u dërgoi një qarkore të gjitha komiteteve të PKSH-ës. “Zbarkimi i aleatëve në Ballkan, ose dhe në Shqipëri, - thuhej në qarkore, - nuk asht një perspektivë e largët ... Duhet që me rastin e zbarkimit të Aleatëve, Këshillat nacionalçlirimtarë të jenë me të vërtetë pushteti i popullit, të mobilizojnë gjithë popullin rreth tyre dhe të mos lejojnë forca të tjera si

duart tona, nesër të shohëm”. *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 20, fl. 1. Letër e Enver Hoxhës për Nako Spirun, 29 shtator 1943. Të gjitha raportet nga komitetet qarkore dëshmojnë për goditje autokolonash gjermane në akset kryesore të vendit, veçanërisht në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut.

⁵⁰ *The National Archives*, London (më tej: TNA), *War Office* (WO), 2049558, HS-AFHQ 144/5, viti 1944, Memorandum: “Shqipëria” përgatitur nga H. Hodgkinson, Zyra e NLO, British Air Force, korrik 1944, në: *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore, në arkivat kombëtare britanike*, përgatitur për botim nga Hamit Kaba dhe Sabit Syla, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë: 2016, f. 292.

Balli Kombëtar të kenë influencë në popull”⁵¹. Ai u kujtonte drejtuesve komunistë lokalë rëndësinë që kishte kjo detyrë, pasi, sipas tij, Aleatët “në momentin e zbarkimit do të përkrahin të gjitha forcat që do të gjejnë përpara, pa preferencë për ato të nacionalçlirimtares dhe madje, ... me preferencë për reaksionarët [kupto: nacionalistët]”. Në të njëjtën letër, Hoxha udhëzonte strukturat e tij që të shtojnë propagandën në popull për ta diskredituar Ballin, në mënyrë që ai ta konsideronte atë (Ballin) si shkakhtar të vëllavrasjes së pashmangshme⁵².

Për drejtuesit më të lartë komunistë, të vendosur në përgatitjen e rrugës për pushtetin monist të së nesërme, lufta civile ishte e pashmangshme, por ata kërkonin të propagandohej Balli, si shkakhtar i saj. Rezolucioni dhe udhëzimet e tjera të dala pas Konferencës së Labinotit u shpërndanë me shpejtësi në të gjitha strukturat politike dhe ushtarake, por jo në të gjitha krahinat, drejtuesit lokalë komunistë reagueshan me të njëjtën shpejtësi ndaj tyre. Në zonën e Korçës, ku ishte përgatitur tashmë terreni, situata erdhi duke u përshkallëzuar. Raportet që drejtuesit komunistë të rajonit të Korçës, Naxhije Dume dhe Pandi Kristo i dërgojnë KQ të PKSH-së dëshmojnë për një situatë shumë të acaruar në marrëdhëniet midis dy grupimeve politike, e cila kishte pasur ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e banorëve të zonës. Për shkak të këtyre konflikteve, ishte tërhequr fokusi nga lufta kundër okupatorit, gjë që siç e tregoi rasti i Vithkuqit⁵³, rezultoi me pasoja katastrofike për të gjithë ato fshatra. Më 7

⁵¹ *AQSH*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 17. Letër e Enver Hoxhës drejtuar të gjithë komiteteve qarkore të PKSH-së, 9 shtator 1943.

⁵² *Po aty*, fl. 21.

⁵³ Më 26 gusht 1943, në orën 6.30 të mëngjesit forcat ushtarake italiane ndërmorën një operacion në zonën Bellovodë-Gjanç-Leshnjë me qëllim të eliminonin Brigadën I të sapoformuar. Më herët një nga drejtuesit e Ballit Kombëtar për Korçën, Fazlli Frashëri, i kishte dërguar një letër Nexhip Vinçanit ku e sinjalizonte për mundësinë e kryerjes së këtij operacioni dhe i ofronte ndihmë për të përballuar forcat ushtarake italiane. Nexhipi e kishte injoruar këtë informatë, duke e konsideruar të rreme. Në kohën kur ushtria italiane sulmoi zonën, brigada ndodhej 5-6 orë larg vendngjarjes. Ndërkohë dhe batalioni “Hakmarrja”, dhe ai i drejtuar nga Riza Kodheli, nuk mundën të arrinin në kohë. Sulmi u përballua vetëm nga forcat e pakta të batalionit “Panariti”, i cili nuk mundi të ndalonte forcat e shumta italiane që nuk hezituan të përdornin edhe sulmet ajrore. Si rezultat i mospërfilljes së një informate të dobishme, Vithkuqi dhe zona përreth u dogj plotësisht nga ushtria italiane. Për më tepër shih: *AQSH*, F.

shtator 1943, batalioni “Hakmarrja” i drejtuar nga Petrit Dume luftoi në Kolonjë me një çetë të Ballit të komanduar nga Muslim Kodrasi. Ky sulm, sipas raportit të Naxhije Dumes, ishte provokuar nga Balli, por kjo nuk ishte e para përplasje e armatosur midis dy grupimeve. Më herët ishte luftuar në Kurtez dhe në Blush⁵⁴. Në ditët e para të shtatorit njerëz të Ballit kishin ekzekutuar në Devoll një kryetar këshilli nacionalçlirimtar dhe një nënkomandant çete partizane, në shenjë hakmarrjeje ndaj një ekzekutimi që forcat e UNÇ-ës kishin kryer ndaj një anëtarit të Ballit. Më 8 shtator 1943, u sulmuan në befasi nga forcat e UNÇ-ës, disa çeta të Ballit të mbledhura në një takim në fshatin Ziçisht. Luftimet mes dy grupimeve vijuan për rreth 2 orë dhe përfunduan me disfatën e çetave të Ballit. Në luftime humbën jetën 6 anëtarë të Ballit Kombëtar midis të cilëve Dr. Kasimati, togeri Hydbi Tresteniku, Zija Gashi, Feti Vërleni e Dilo Graca. Humbjet e partizanëve nuk janë të qarta. Sipas relacionit të komandantit të çetës së Ballit Kombëtar për Devollin, Fuat Çermenika në luftime kishte mbetur i plagosur të paktën një partizan, i cili kishte vdekur disa ditë më vonë⁵⁵.

Duket se këto sulme nuk janë incidente të pakontrolluara, por zbatimi i vendimeve politike. Sipas raportit të Naxhije Dumes, komiteti qarkor i PKSH-së për Korçën kishte rënë dakord se: “ne duhet t’i përgjigjemi me luftë për ndryshe Balli do të marrë supremacin dhe t’a zgjerojë luftën në të tëra anët e do të na izolojë në shumë zona; luftën kundër Ballit do t’a drejtojmë kundra elementëve më reaksionarë që do t’i nxirnim para popullit (me anën e shtypit) tradhëtarë me damkë; këtë do ta bënim për të arijtur ti shkëpusim nga Balli ata elementë që lëkundeshin e që s’kanë frymën e reaksionarëve të vërtetë. Tipat më reaksionarë janë Safeti [Butka], Myslim Kodrasi, Musa Moglica; ndërkohë që do të ishim në luftë me Ballin do të përgatitnim dhe goditje kundra ushtrive okupatore se po t’a lejshim pas dore këtë mund të humbiste karakter lufta e jonë. Këto vendime ia komunikuam Dunavecit. Ay i gjente pak të forta e jashtë forcavet tona, por tash që gjendja me

14/APL, V. 1943, D. 31, fl. 2. Letër e Dunavecit (Pandi Kristos) për Enver Hoxhën, 7 shtator 1943.

⁵⁴ *Po aty*, fl. 1/6. Letër e Fortunës (Naxhije Dumes) për KQ të PKSH-së, 8 shtator 1943.

⁵⁵ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 41, fl. 6-8. Raport i komandantit të çetës së Ballit Kombëtar të Devollit, Fuat Çermenika, për komitetin qarkor të Ballit Kombëtar të Korçës, pa datë.

Ballin mori karakter me të ashpër dhe Dunaveci asht dakord⁵⁶. Në qarkun e Korçës sulmet ndaj Ballit Kombëtar vijuan gjatë gjithë shtatorit. Më 19 shtator 1943, një tjetër përplasje e armatosur ndodhi midis forcave të UNÇ-ës dhe atyre të Ballit Kombëtar në Goskovë të Korçës, si rezultat i së cilës vrau veten drejtuesi i Ballit Kombëtar të Kolonjës, Safet Butka.

Ndryshe nga Korça, në Gjirokastrë dhe Berat situata nuk kishte shkuar sipas udhëzimeve të KQ të PKSH-së. Në Gjirokastrë, më 11 shtator 1943, forcat e Ballit Kombëtar hynë në qytet dhe morën në dorë qeverisjen e tij: bashkinë, bankën, burgun prej të cilit i liruan të gjithë të burgosurit. Njëri prej komandantëve të Ballit, Skënder Muço i dërgoi një letër shtabit të forcave nacionalçlirimtare në të cilën e njoftonin se Gjirokastra është në duart e shqiptarëve dhe kërkonte një përfaqësues të LNÇ për të bashkëpunuar dhe bashkërenduar veprimet. “Çasti është kritik, - thuhet më tej në letër, - nuk lypset t’i shmangemi detyrës që na imponojnë rrethanat dhe lufta kundër okupatorit të ri, interesat e larta të kombit dhe ato të demokracisë shqiptare. Në qoftë se nuk do t’i përgjigjeni kësaj thirrjeje të sinqertë nga ana jonë, me hovin që na imponohet nga çasti na duket se merrni një përgjegjësi të rëndë para popullit⁵⁷”.

Drejtuesit lokalë të PKSH-së së Gjirokastrës në raportet e tyre flisnin për pakënaqësitë që kishte shkaktuar qeverisja e Ballit në qytet, për shkak të taksës të së dhjetës, e cila ishte kërkuar menjëherë. Gjithsesi, përveç konferencave dhe debateve publike midis krerëve lokalë të dy grupimeve, nuk mori asnjë masë për ta larguar Ballin nga qyteti.

Në Berat, ishin forcat e UNÇ-ës të parat që hynë në qytet. Drejtuesi i PKSH-së për Beratin, Gjini Marku, duke parë epërsinë numerike të forcave të Ballit Kombëtar nuk i pengoi ato të hynin në qytet⁵⁸. Për një kohë, Berati u qeveris nga të dy grupimet politike. Sipas raportit të Gjini Markut dhe Kahreman Yllit “me Ballin që ka Bashkin dhe zyrat e fashos nuk jemi marrë vesh⁵⁹”. (Në) një tjetër raport më të gjatë, Gjini Marku do të sqarojë se i vendosur midis presionit të ushtrisë italiane që nuk

⁵⁶ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 31, fl. 1/6. Letër e Fortunës (Naxhije Dumes) për KQ të PKSH-së, 8 shtator 1943.

⁵⁷ U. Butka, *Lufta civile ...*, f. 78-79.

⁵⁸ *AQSH*, F. 19/APL, V. 1943, D. 2, fl. 10. Letër e Malësorit (Gjini Marku) për KQ të PKSH-së, 22 shtator 1943.

⁵⁹ *Po aty*.

pranonte të dorëzohej dhe të çarmatosej, epërsisë numerike të Ballit Kombëtar që gjendej në qytet, ai kishte qenë i detyruar të bëjë një marrëveshje me forcat ushtarake gjermane, sipas të cilës ata nuk do të hynin ushtarakisht në qytet, por do të lejoheshin të blinin mallra për nevoja të ushtrisë⁶⁰.

Të dy rastet e mësipërme dëshmojnë se për krerët e Ballit Kombëtar nuk paraqiste problem ndarja e pushtetit me PKSH/LNÇ. E kundërta mund të thuhet për drejtuesit e PKSH-së. Enver Hoxha është shumë kritik në një letër që i dërgon Liri Gegës për drejtuesit komunistë të Beratit dhe Gjirokastrës. Sipas tij, në Gjirokastrën e çliruar nga ushtria italiane kishin hyrë rreth 600 forca të Ballit Kombëtar të drejtuara nga Ali Këlcyra, Bahri Omari dhe Koço Muka. Forcat partizane, që kishin në epërsi të dukshme numerike (rreth 1500 vetë) “në vend që t’i s’pastrojnë ata plehra që andej, po kënaqen me një luftë politike kundrejt tyre dhe gjatë kësaj kohe Balli vazhdon punën e tij. Puna politike kundër Ballit nuk duhet të jetë e vetmia në këto raste, ajo duhet të ndihmojë luftën ushtarake e cila duhet të jetë decizive; nuk mjaftojn metinge e konferenca por duhet me një herë të març pushtetin e të organizoç komandat dhe të stabilizoç pushtetin e Këshillave dyke mbajtur disiplinën, rregullin dyke organizuar jetën në qytet dhe dyke lëftuar me ashpërsin më të madhe dhe me pushkë në dorë, të gjithë padrejtësitë dhe vjedhjet që i bëhen popullit nga kush do që të jetë”⁶¹. Urdhri i tij ishte i qartë “Balli nuk ta lëron pushtetin dhe as kush tjetër në qoftë se nuk e rrëmben me forcë pse është e drejta tënde dhe e popullit”⁶².

Balli Kombëtar u mundua t’i kundërpërgjigjej sulmeve të PKSH-së. Gjatë muajit shtator 1943, komunikimi publik i Ballit ishte përqendruar në tre kahje: fajësimin e komunistëve për dështimin e Marrëveshjes së Mukjes dhe përfshirjen e vendit në një luftë “vëllavrasëse”; dënimin e pushtimit të vendit nga Gjermania naziste; dhe të vijonte në deklarimin e qëndrimit pro Aleancës së Kombeve të Bashkuara. “Na e ndjejmë vehten një ndër popujt e robëruar, thuhet në një trakt të shpërndarë në Berat më 22 shtator 1943, - dhe, si të tillë, jemi aleatë të popujve të mbëdhenj të

⁶⁰ *Po aty*, fl. 9. Letër e Malësorit (Gjin Marku) për KQ të PKSH-së, 22 shtator 1943.

⁶¹ *Po aty*, F. 14APL, V. 1943, D. 22, fl. 3. Letër e Enver Hoxhës për Muzhikun (Liri Gegën), 1 tetor 1943.

⁶² *Po aty*.

Anglisë, Amerikës dhe Unionit Sovjetik që kanë marë përsipër çlirimin e popujve. Këtë gjë e kemi treguar edhe me fakte. Mjafton të kujtojmë luftat e çetave t'ona të Vlorës dhe të Korçës kundër okupatorit gjerman⁶³. Në një trakt tjetër të shpërndarë më 27 shtator 1943, Komiteti Qendror i Ballit Kombëtar dënonte pushtimin gjerman të Shqipërisë dhe denonconte formimin e Komitetit Ekzekutiv. “Pas dorëzimit të ushtërive italiane pa kushte, - thuhet në të, - gjermanët që ndodhen në Shqipëri, që tregohen gjoja si miq të Kombit t'onë(!) – mos harroni se kur italianët okupuan Shqipërinë, vetë Hitleri tha me gojën e tij: “U-bë mirë, se kështu do të kenë rast të qytetërohen 1.000.000 barinj të egër! – me nisjativën e tyre formuan në Tiranë një “Komitet Ekzekutiv”, të përbërë prej Ibrahim Biçakut, Lef Nosit, Ismail Sefës, Mihal Zallarit e të tjerë, me qëllim që të qeverisin vëndin, siç e qeverisnë edhe Mustafa Merlika, Maliq Bushati, Kol Bib Mirakaj e Co.!!”⁶⁴. Në të njëjtin trakt, shprehej gatishmëria e Ballit për të luftuar kundër pushtuesit të ri. “Qëndrimi i “Ballit” në këtë vijë është i caktuar: jemi kundër okupatorit gjerman që kërkon t'a bëjë vëndin t'onë fushë mjerimi e rënimi. Dhe lufta kundër tyre është e çelët: çetat t'ona kanë urdhër të prerë të luftojnë okupatorin e ri në çdo kënd të tokës arbënore”⁶⁵. Organizata reagoi ashpër edhe ndaj përfshirjes së dy anëtarëve të saj në Komitetin Ekzekutiv dhe vendosi “rëxim nga anëtarësia e “Ballit Kombëtar” të Lef Nosit dhe Ismail Sefës, përgjegjësia e të cilëve do të caktohet sipas regullave të Organizatës”⁶⁶.

Në gjysmën e dytë të shtatorit, dokumentet tregojnë qartë se rivaliteti që kishte pasur midis dy grupimeve politike dhe ushtarake i kishte lënë vendin armiqësisë. Në këtë situatë, ndërsa krerët e Ballit Kombëtar përpiqeshin të gjenin aleatë në luftën e tyre kundër komunistëve⁶⁷, këta të fundit e kishin strukturuar fushatën politike dhe ushtarake kundër Ballit Kombëtar. Në një letër që Ramadan Çitaku i

⁶³ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 21, fl. 1. Trakt i Ballit Kombëtar në Berat, 22 shtator 1943.

⁶⁴ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 11, fl. 36. “Balli Kombëtar” dhe Komiteti Ekzekutiv i Tiranës”, trakt i KQ të Ballit Kombëtar, 27 shtator 1943.

⁶⁵ *Po aty*.

⁶⁶ *Po aty*.

⁶⁷ Gjatë shtatorit 1943, krerët e Ballit Kombëtar u takuan me shumë prej krerëve lokalë të veriut të Shqipërisë. Në takimin e Lumës, ata organizuan një besëlidhje e cila kishte dy qëllime: luftë kundër komunizmit dhe për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare.

dërgonte Enver Hoxhës më 1 tetor 1943, kuptohet qartë nxitja e armiqësisë ndërmjet dy grupimeve politike. “Në raportet e Koçit [Xoxe] qi po dërgojmë, - shkruan Çitaku, - shifet një aktivitet mjaft i gjallë si në luftë kundra okupatorit ashtu dhe kundra tradhtarve e “Ballit Kombëtar”. Safet Butka dhe Hysni Lepenica na muerën të keqen, harifshim edhe në kokën e Abaz Ermenit”⁶⁸. Fakti që drejtuesi i PKSH-së shprehej me ton sarkastik për vdekjen e dy prej komandantëve më aktivë të Ballit në rezistencën kundër pushtuesit italian, si dhe formulonte urimin për vdekjen e shpejtë të Abaz Ermenjit, i cili së bashku me Skënder Muçon dhe ndonjë tjetër, jo vetëm vijonin rezistencën kundër pushtuesit gjerman, por edhe marrëdhëniet me misionet britanike, dëshmon qartë se ishte ideologjia dhe perspektiva e pushtetit të së nesërm që përcakonte armiqësitë.

Krahas trakteve dhe shkrimeve në gazetat “Zëri i Popullit” dhe “Bashkimi”, Balli Kombëtar filloi të goditej me anë të bejteve e këngëve denigruese si organizatë tradhtarë, e cila kishte bashkëpunuar me pushtuesit kundër interesave të vendit. Në letrën e sipërcituar, R. Çitaku dëshmon mbi zbatimin e kësaj fushate në qytetin e Elbasanit. “Me sa shof unë, - shprehet në letër Çitaku, - popullin e paskemi mbajt me zorë qi të mos mari një qëndrim të premë kundra Ballit. Të ndigjojsjsh gjanat se çfarë bajnë vaki, vdes së qeshuni. Burra pleq, se rininë e lamë me një anë, kur kalon ndoj ballist afër tyne i thonë njeni-tjetrit “ta lash” dhe ballistat janë ba qi nuk munden me dal në pazar. Kanga e Ballit ka marrë dhen dhe rrugët e qytetit ushtojnë prej rinisë. Pjesa e rinisë 12 vjeçare (të rritunit janë serjoza dhe bajnë demaskimin politik) grumbullohen dhe porsa shohin ndoj ballist (fatmirësisht janë shumë pak n’Elbasan) fillojn t’i këndojn “Dhe gërthasin si gomar, jemi Balli Kombëtar”⁶⁹. Ramadan Çitaku tregohet i sinqertë në informacionin e tij, duke dëshmuar se situata në qytetin e Elbasanit nuk i ngjan të gjithë qarkut, në shumë prej krahinave të së cilit, Balli Kombëtar ka influencë të dukshme. “Në krahina gjendja asht krejt ndryshe: Nga ana e Librazhdit kanë dalë nja dy a tre reaksionarë të cillët kanë mobilizue sikurse thotë populli 200 veta për kundra çetave. Këta nganjëherë e quejnë veten Ballist por këta janë

⁶⁸ AQSH, F. 14/APL, V. 1943, D. 25, fl. 27-34. Letër e Ramadan Çitakut për Enver Hoxhën, 1 tetor 1943.

⁶⁹ *Po aty*.

njerëz të Beut (Vërlacit), i cili po bahet aktiv këto kohët e fundit. Do të jetë njeriu ma reaksionar i kësaj prefekturë dhe do të luej dallaveret ma të mëdhaja⁷⁰. Njëkohësisht me fushatën denigruese kundër Ballit Kombëtar bëheshin përpjekje për dërgimin e sa më shumë vullnetarëve për formacionet e UNÇ-ës. Si rezultat, gjatë muajit shtator po përgatitej formimi i dy brigadave të tjera të UNÇ-ës, gjë që më shumë në planin politik, sesa atë ushtarak, pati ndikim të rëndësishëm në popull.

Fuqizimi i formacioneve ushtarake u dha qetësinë drejtuesve të lartë komunistë që të shoqëronin propagandën me masa edhe më drastike. Ndryshe nga dy muaj më parë, kur flitej për gjetjen e rrugëve të bashkëpunimit me Ballin Kombëtar, tashmë politika e PKS-ës ishte për ta eliminuar ushtarakisht atë. “Neve mendojmë, - i shkruante Ymer Dishnica, Enver Hoxhës, më 1 tetor 1943, që t’i bëhet B[allit] Komb[ëtar] një ofensivë me stil të gjerë, të spastrohen kërret reaksionarë me gjithë çetat e tyre; një ofensivë politike dhe ushtarake që të mos na gjejë me pengesa nëpër këmbë me rastin e një zbarkimi engles sidomos tashti, që po e nxjerrin majën e veshit⁷¹. Po atë ditë, Enver Hoxha u dërgon të gjitha komiteteteve qarkore të tij letrën në të cilën urdhëron të goditen çetat e Ballit⁷².

Si përfundim, gjatë muajve gusht-shtator 1943, për shkak të ndryshimeve në *skakierën* e Luftës së Dytë Botërore, sigurimi i epërsisë politike si parakusht për marrjen e pushtetit të pasluftës, filloi të dominojë politikën shqiptare. Qëllimi i PKS-ës për të marrë e vetme këtë pushtet përcaktoi marrëdhëniet e saj me Ballin Kombëtar. PKS/LNÇ u tregua më largpamëse në politikën e saj për të mos e ndarë rezistencën kundër pushtuesit me përpjekjet për të eliminuar kundërshtarët politikë. Ajo arriti të sigurojë epërsi politike në planin e brendshëm, pasi arriti të fitonte mbështetjen e një mase dërmuese të popullsisë, por edhe e shndërroi LNÇ në një faktor në marrëdhëniet me Aleatët e Kombeve të Bashkuara.

⁷⁰ *Po aty*.

⁷¹ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 21, fl. 31-33. Letër e Ymer Dishnicës dhe Nako Spirut për Enver Hoxhën, 1 tetor 1943.

⁷² *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 35-39. Letër e Enver Hoxhës drejtuar komiteteteve qarkore të PKS-ës, 1 tetor 1943.

Krerët e Ballit përcaktuan nacionalizmin dhe antikomunizmin si themelet e politikës së tyre. Ali Këlcyra në një fjalim të mbajtur në Gjirokastrë në fund të shtatorit 1943, shprehej se Balli Kombëtar nuk ishte kundër komunizmit si ideologji, por kundër modelit të qeverisjes që ai propozonte. Ai u kujtonte banorëve të qytetit sesa e rrezikshme kishte qenë për Evropën, tolerimi i regjimeve totalitare nga ana e Fuqive të Mëdha, duke aluduar se nuk duhej të bëhej i njëjti gabim, me tolerimin e një regjimi të ri totalitar, si ai i komunistëve. “Atituda e Fuqive të Mëdha, - u shpreh ai, - tepër e plogët dhe e rezervuar para arrogancës dhe provokimeve të shteteve totalitare, para luftës, gaboj keqazi Hitleri dhe Musolini, të cilët ja atribuuan këtë gjendje shpirtërore të demokracisë përgjithësisht aleatëve, dhe i shtynë ata të bëjnë aktin fatal, duke hedhur botën dhe vendet e tyre në këtë katastrofë të tmerëshme. S’ka aspak dyshim se po të na bëhet një provokim prej anës Komuniste, ajo që ngjau në botën e madhe do të ngjajë dhe në këtë botën t’onë shqipëtare: Nacionalizma do të qëndrojë si një shkëmb i pa tundur, cilat do qofshin tallazet e jetës politike”⁷³. Por, ndërsa synimet e tyre ishin largpamëse, mungesa e unifikimit të veprimeve dhe qëndrimeve politike i bëri ata jo efektivë kundër “kurthit” të ngritur nga PKSH. Në muajt në vijim, disa vendime të nxituara politike e devijuan tërësisht projektin e organizatës si një forcë e rezistencës kundër pushtesit, gjë që i dha mundësi PKSH-së ta eliminojë plotësisht atë.

S u m m a r y

COMMUNIST PARTY OF ALBANIA AND BALLI KOMBËTAR DURING AUGUST- SEPTEMBER 1943

The months of August-September 1943 are a turning point in the relations between the belligerent Blocs of the World War II, which had an undeniable influence in Albania. The successes of the "Red Army" on the Eastern Front; the fall of Mussolini's government after the Badoglio's coup, and above all the news spread by the Western Allies about the opening of the

⁷³ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 11, fl.37-39 Trakt i Ballit Kombëtar mbi fjalimin e Ali Këlcyrës në Gjirokastrë, 28 shtator 1943.

second front in the Balkans, changed drastically the attitudes of the political forces in Albania towards each other. The rivalry, problems and contradictions that had existed until then between the two largest non-fascist groups in the country: the Communist Party of Albania (CPA) and the National Forefront (Balli Kombëtar), were now turning into a fierce confrontation, all the way up to an armed conflict.

Most scholars acknowledge that August 1943, especially the failure of the Mukje Agreement, brought about a drastic change in relations between the National Forefront and the CPA, and also in the resistance of the Albanians against the Italian and German invaders. The question of political power for both sides began to be discussed no longer as an issue that belonged to the future, but as a reality for which immediate solutions had to be found. It was the subject of political domination and the power of tomorrow that set these groups against each other. The difference between the two political formations lay in the methods of how they would achieve their long-term goals and the model of political system they proposed for post-war Albania. While the CPA aimed at a monistic political system, which was clearly expressed in the decisions of the Second Conference of the National Liberation Council, held in Labinot (4-8 September 1943), the National Forefront defended the idea of a multi-party democracy.

This article focuses on the analysis of relations between the two political groups in Albania: CPA/NLM and National Forefront. It aims to analyze the reasons and factors that influenced the strained relations between them that ended in a civil war, which became one of the features of the history of World War II in Albania.